L I G J
Nr.8101, datë 28.3.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7788, DATË 9.2.1994; LIGJIN NR.7852, DATË 29.7.1994 DHE LIGJIN NR.7899, DATË 2.2.1995

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.7788, datë 9.2.1994; ligjin nr.7852, datë 29.7.1994 dhe ligjin nr.7899, datë 2.2.1995, bëhen këto ndryshime:

Në nenin 3, pika "Taksë pastrimi" ndryshohet në "Taksë për largimin dhe trajtimin e mbeturinave publike"

Në nenin 7, pika "C" ndryshohet si vijon:

"Taksa për largimin dhe trajtimin e mbeturinave publike caktohet si vijon:

- Taksës për largimin dhe trajtimin e mbeturinave publike do t'i nënshtrohen gjithë personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, të cilët jetojnë e ushtrojnë veprimtari të ndryshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

I. Taksat për largimin e mbeturinave publike

a) Taksa për largimin e mbeturinave shtëpiake caktohet 10 lekë në muaj për çdo anëtar të familjes.

b) Taksat për largimin e mbeturinave joshtëpiake caktohen:

- për veprimtaritë e riparim-shërbimeve dhe artizanale - 35 lekë në muaj për çdo vend pune;
- për veprimtaritë në ushqimin social, punishte etj., - 45 lekë në muaj për çdo vend pune;
- për restorantet e kategorisë së lartë - 20 lekë në muaj për çdo vendulje;
- për restorantet e kategorisë së mesme - 10 lekë në muaj për çdo vendulje;
- për lokalet e kafenetë - 10 lekë në muaj për çdo vendulje;
- për restorantet e zonave turistike në sezon turistik - 10 lekë në muaj për çdo vendulje;
- për restorantet e ushqimit të shpejtë me sipërfaqe deri 5 m2 - 200 lekë në muaj. Për çdo m2 më tepër - 10 lekë në muaj;
- për kioskat me sipërfaqe deri në 10 m2 - 300 lekë në muaj. Për çdo m2 më tepër - 10 lekë në muaj;
- për dyqane mishi, peshku dhe mini e supermarket me sipërfaqe deri 20 m2 - 300 lekë në muaj. Për çdo m2 më shumë - 10 lekë në muaj;
- për tezgat e qendrueshme - 200 lekë në muaj;
- për tezgat e paqëndrueshme - 10 lekë në ditë;
- për dyqane të tjera me sipërfaqe deri 20 m2 - 300 lekë në muaj. Për çdo m2 më shumë - 10 lekë në muaj.
- për konviktet - 5 lekë në muaj për person;
- për shkollat e të gjitha kategorive - 5 lekë në muaj për person;
- për kopshtet e çerdhet - 2 lekë në muaj për person;
- për qendrat spitalore - 10 lekë në muaj për çdo krevat;
- për kinematë, teatrot, sallat e mbledhjeve, ekspozitat, galeritë e arteve e mjedise të tjera të ngjashme me to - 20 lekë në muaj për m2.

II. Taksat për përpunimin me kompostim të mbeturinave publike.

a) Taksa për përpunimin me kompostim të mbeturinave shtëpiake caktohet 20 lekë në muaj

për çdo person.

b) Taksat për përpunim me kompostim të mbeturinave joshtëpiake caktohen:

- për veprimtaritë e riparim-shërbimeve dhe artizanale - 160 lekë në muaj për çdo vend pune;
- për veprimtaritë në ushqimin social, punishte etj. - 250 lekë në muaj për çdo vend pune;
- për restorantet e kategorisë së lartë - 100 lekë në muaj për çdo vendulje;
- për restorantet e kategorisë së mesme - 60 lekë në muaj për çdo vendulje;
- për lokalet e kafenetë - 50 lekë në muaj për çdo vendulje;
- për restorantet e zonave turistike në sezon turistik - 60 lekë në muaj për çdo vendulje;
- për restorantet e ushqimit të shpejtë me sipërfaqe deri 5 m2 - 750 lekë në muaj. Për çdo m2 më tepër - 75 lekë në muaj;
- për kioskat me sipërfaqe deri 10 m2 - 1500 lekë në muaj. Për çdo m2 më tepër - 75 lekë në muaj;
- për dyqane mishi, peshku dhe mini e supermarketë me sipërfaqe deri 20 m2 - 1500 lekë në muaj. Për çdo m2 më shumë - 75 lekë në muaj;
- për tezgat e qendrueshme - 850 lekë në muaj;
- për tezgat e paqëndrueshme - 20 lekë në ditë;
- për dyqane të tjera me sipërfaqe deri 20 m2 - 1000 lekë në muaj. Për çdo m2 më shumë - 50 lekë në muaj;
- për konviktet - 21 lekë në muaj për person;
- për shkollat e të gjitha kategorive 21 lekë në muaj për person;
- për kopshtet e çerdhet - 8 lekë në muaj për person;
- për qendrat spitalore - 42 lekë në muaj për çdo krevat;
- për kinematë, teatrot, sallat e mbledhjeve, ekspozitat, galeritë e arteve e mjedise të tjera të ngjashme me to - 83 lekë në muaj për m2".

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Në pjesën ku flitet për lënien e përqindjes së caktuar të masës së taksave të vjela, pika “B” për taksat lokale, nënpika “a” ndryshohet si vijon:

"a) për taksën për largimin dhe trajtimin e mbeturinave publike:

- 5 për qind për persona juridikë shtetërorë;
- 15 për qind për persona privatë fizikë a juridikë."

2. Në pjesën ku flitet për organet që ngarkohen me nxjerrjen e taksave, pika “B” për “taksat lokale”, nënpika “c” ndryshohet si më poshtë:

"c) për taksën për largimin dhe trajtimin e mbeturinave publike ngarkohet shërbimi postar i shoqërisë publike të postave shqiptare ose persona privatë fizikë a juridikë."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1461, datë 9.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha